



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Datë: 07.03.2025
Numër Protokolli: 1584/2025

A.nr.117/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Ylber Fetahaj, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.117/2025, të datës 16.01.2025, të parashtruar nga ankuesi F.A., kundër organit të punësimit: Inspektorati i Punës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.117/2025, të datës 16.01.2025, të parashtruar nga ankuesi, F.A.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil F.A.(në tekstin e mëtejme referuar Ankuesi), më datë 16.01.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me procedurën e pranimin me numër reference RN00015135, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “*Inspektor i Punës*” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Pejës , të shpallur nga Inspektorati i Punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.117/2025, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Inspektorati i Punës më datë 13.09.2024, ka shpallur konkursin me Nr. referencës RN00015135, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita Inspektor i Punës, në Divizionin e Koordinimeve në Rajonin e Pejës, klasa profesional 1, numri i kërkuar 7 vende, me afat aplikimi 14.09.2024 deri 13.10.2024.

Tutje sipas provave materiale të çështjes del së në konkursin përkatës kanë aplikuar 173 kandidatë përfshirë edhe ankuesin, i cili e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak, ndërsa, e njëjti ju ka nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë por nuk ka arritur të shpallet kandidat fitues.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e kundërshtuar rezultatet e testit me shkrim, si dhe vlerësimin në intervistën me gojë me supozim se i njëjti nuk është vlerësuar në mënyrë meritore, ndërsa konkursin me numër Reference RN00015135, për pozitën Inspektor i Punës ta anulohet në tersi.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezultojnë se kandidatja, A.C., si kandidate aplikuese në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015135, më datë 03.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë pranimit, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.01/2025, të datës 17.02.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015135, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht pozitën “Inspektor i Punës” – Divizioni i Koordinimeve në Rajonin e Pejës, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes së faktëve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.117/2025, të datës 16.01.2025, ka të bëjë me kontestimin e procedurës së njëjtë të pranimit, për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.01/2025, të datës 17.02.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015135, si një qëllim i propozuar nga ankuesi në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.117/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundojë procedimin administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.117/2025, të datës 16.01.2025.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.117/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore Gashi-Bajraktari

Kryetare e Kolegji

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit F.A.;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.